

Drive

PORSCHE
ALBANIA

06/16

04

Rritje e Qëndrueshme

A Steady Growth

06

Audi i Ri Q2

New Audi Q2

08

Volkswagen E-Golf



12

Një SUV Spanjoll

A Spanish SUV

22

Google Street View

> Përmbajtja Content



6



8



9



12



16



22

3	I dashur lexues / Dear Reader
6	Audi i Ri Q2 / New Audi Q2
8	Volkswagen E-Golf
9	E-Servis
10	Në Udhëtim / On The Road
12	Një SUV Spanjoll / A Spanish SUV
16	Një Arsye / One Reason
19	Ishulli që ndryshoi emrin The island that changed the name
20	Makinë e përdorur? Urdhëroni! Used vehicle? Welcome!
22	Google Street View
23	Makina Ime / My car

Revista Drive është një botim periodik i Porsche Albania.

Realizimi: Botues Porsche Albania,
Realizimi grafik: Sourceone

Burimi: Audi: Audi-Mediaservice.com,
SEAT: media.SEAT.com,
VW Makina Tregtare:
volkswagen-media-services.com,
VW Das Auto Magazine
ŠKODA: press.ŠKODA-auto.com.

Për komente, pyetje apo sygjerime ju lutem na kontaktoni në office@porsche.al ose në numrin e telefonit: +355 (04) 240 74 30.

Porsche Albania,
Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 7, Rr. Monun.
Telefon: +355 (04) 240 74 30, Fax.: +355 (04) 240 74 34,
e-mail: office@porsche.al; <http://www.porsche.al>

I dashur lexues, Dear Reader,

Drive with us

Gentian Bushati - Drejtor i Përgjithshëm Porsche Albania
General Manager Porsche Albania



> Prej 5 vjetësh tashmë kemi zgjedhur të vendosim një urë komunikimi me klientët, partnerët e biznesit, miqtë e kolegët e Porsche Albania-s nëpërmjet revistës Drive. Këto 5 vite histori kanë bërë që revista Drive të jetë një mundësi më shumë për t'ju informuar me të reja në fushën e teknologjisë dhe inxhinierisë të markave të Grupit Volkswagen, arrijtjet, eksperiencat si dhe sfidat e tregut automobilistik në Shqipëri por edhe më gjerë.

Pas zgjerimit, në tetor të 2015-s, të mundësive tona të shërbimit me dy sallone të reja (Volkswagen dhe Audi), kapaciteteve të dyfishuara në servis dhe pjesë këmbimi, investimet vazhdojnë. Si marka me performancën më të mirë në tregun e makinave të reja për pasagjerë, ŠKODA ka tashmë një sallon tërësisht të rikonstruktuar me standardet e përcaktuara nga fabrika prodhuese. Në Porsche Albania ne jemi krenarë për këto investime që në total kapin vlerën e rreth 1 milion euro-ve.

Marka ŠKODA vjen tashmë në treg si alternativë e parë për partnerët dhe klientet tanë. Ky investim në sallonin e markës ŠKODA do bëjë të mundur që ne t'ju shërbejmë

klientëve tanë jo vetëm me më tepër profesionalizëm por edhe në kushte më moderne. Falë investimeve të bëra do të kemi mundësi t'ju ofrojmë shërbime më të përparura si në fushën e shitjeve ashtu edhe në shërbimet e passhitjes. Konceptimi i ri i salloni dhe servisi na jep mundësi të orientojmë edhe më tepër të gjithë proceset tona rreth jush dhe nevojave tuaja.

Për të qenë më të mirë dhe me të sukseshmit në tregun Shqiptar kërkohet punë dhe përkushtim por edhe vision dhe guxim. Porsche Albania shpejt do të hap një kapitull të ri në mënyrën e të udhëtuarit në Shqipëri. Prej kohësh tashmë kemi punuar për të ndërtuar infrastrukturën e nevojshme për të tregëtuar dhe ofruar shërbimet e pas shitjes mjeteve tërësisht elektrike. Ky hap na vendos në një pozitë avangard në tregun Shqiptar. Krijon mundësi krejtësisht të reja biznesi dhe si rrjedhojë edhe mendësi të reja përsa i përket mobilitetit, kostove të mirëmbajtjes, perceptimeve të reja ambientaliste si dhe një realitet krejtësisht të ri për partnerët tanë. Ne në Porsche Albania jemi të sigurt që në të ardhmen Volkswagen Group do të zhvillojë edhe më tej gamën e makinave elektrike si pjesë e strategjisë 2025 dhe ne do ti sjellim,

në kohën më të shkurtër të mundshme, këto zhvillime në tregun Shqiptarë, duke ngulur gjithmonë inovativ dhe strategjik në mënyrën e të bërit biznes në vendin tonë.

Përgjatë vitit ka patur dhe do vazhdojë të ketë një ofensivë modelesh të reja, ku me shumë kënaqësi do përmendja, Volkswagen Tiguanin e ri (Maj 2016), SEAT Ateca e re SUV e parë nga Marka Spanjolle (Tetor 2016), Audi Q2 (Dhjetor 2016) etj. Mjafton një vështrim i shpejtë në këtë rrjeshtim modelesh të reja për të kuptuar se fokusi këtë vit për grupin Volkswagen do të jetë segmenti SUV (sport utility vehicles).

Ecuria në gjashtëmuorin e parë na bëjnë të jemi optimist që edhe ky vit do të jetë një tjetër vit suksesi për Porsche Albania-n. Në faqet në vijim do keni mundësi të lexoni më tepër mbi këto por edhe shumë informacione të tjera nga Porsche Albania.

Në përfundim, ju uroj suksese në planet tuaja edhe në gjysëm të dytë të vitit.

Lexim të mbarë,

> Since 5 years now, we have chosen to establish a communication bridge with the customers, business partners, friends and colleagues of Porsche Albania, through the 'Drive' magazine. During this time we have seen 'Drive' as an important asset of communicating the latest innovations of the Volkswagen Group, the achievements, experiences and challenges of the Albanian automotive market and much more.

Following the expansion in October 2015 of our operational capabilities with two new showrooms (Volkswagen and Audi), the doubled capacity in service and spare parts, our investments continue. As the brand with the best performance in the new passenger vehicles, ŠKODA now has an entirely renovated showroom, in compliance with the brand's and factory standards. At Porsche Albania we are proud of these investments that in total reach the figure of around 1 million Euro.

ŠKODA brand is now the first alternative for

our clients and business partners. Through this investments it would be possible to serve our clients needs not only more professionally but in a more modern set up. Additionally it would be possible for us to offer a new range of services both in the sales and the after sales department. The new design of the showroom will enable us to further tailor our services to Your needs.

Market leadership needs work and dedication but also vision and courage. Porsche Albania will soon start a new chapter in the nature of mobility in Albania. It has been a while since we have started to build the necessary infrastructure for selling and servicing fully electrical vehicles. This initiative improves further the leading position of Porsche Albania in the market. It generates a completely new set of business possibilities in terms of mobility, servicing costs, environmental approach and a brand new reality for our business partners. At Porsche Albania we are confident that Volkswagen Group will further develop its electrical car range as part of its

2025 strategy and we continue to shorten the lead time to introduce these developments in Albania.

During this year, we will have an offensive of new models, whereby I am very pleased to mention the new Volkswagen Tiguan (May 2016), the new SEAT Ateca the first SUV from SEAT (October 2016), the new Audi Q2 (December 2016), etc. It would be enough to take a quick look at the lineup of these new models to realize that the focus for this year for the Volkswagen Group will be the SUV (sport utility vehicles) segment.

The results of the first half of the year gives us the confidence that this year will be another successful achievement for Porsche Albania.

In the end I would like to wish you a successful second half of the year.

Enjoy,

Rritje e qëndrueshme

A steady growth

Të ardhura / Turnover

18.8 miliard €
/billion €

Pika shitjeje / Dealership

628



Salzburg, 16 mars 2016 - Porsche Holding Salzburg (PHS) arriti një tjetër performancë shumë të suksesshme në vitin 2015, duke vendosur rekorde të reja në xhiro dhe automjete të shitura.

Xhiro e konsoliduar u rrit me 10.2% krahasuar me vitin 2014 në 18.8 miliard €.

Një total prej 927,393 automjeteve të reja dhe të përdorura u shitën në sipërmarrjet me shumicë dhe pakicë, një rritje prej 6.9% krahasuar me vitin paraardhës. Mjetet e reja përbënin 670,602 njësi (+7.6%), dhe ato të përdorura 256,791 njësi (+5.2%).

Në mes të vitit 2015, PHS mori përgjegjësinë e tregut për Bosnje-Hercegovinën, çka do të thotë që tani është e pranishme në të gjithë rajonin EQL si importues dhe tregtues i markave të Grupit Volkswagen.

Kompania aktualisht ka sipërmarrje me shumicë dhe pakicë në 25 vende dhe punëson 33,124 persona në mbarë botën (+2.5%).

Rajoni EQL mbetet në një trajektore në ngjitje

Me përjashtim të Ukrainës, tregu i gjithanshëm në vendet e EQL u rrit me ritëm të fortë në disa raste, edhe pse nuk arriti të kapte pikën e lartë të tregut të vitit 2008.

Në të 14 tregjet ku PHS përfaqësohet në këtë rajon, ajo kapërceu rritjen ekonomike rajonale. Me një pjesë tregu prej 18.9% (+0.2%), përmirësoi në mënyrë domethënëse performancën e vet në treg.

Rritjet më të mprehta u regjistruan në Republikën Çeke, në Hungari dhe Rumani si dhe në Shqipëri dhe Maqedoni.

Porsche Česká Republika, importuesi më i madh PHS për nga vëllimi pas Austrisë, rriti

shitjet e makinave të reja në 49,156 automjete (+37.2%).

"Jemi shumë të kënaqur me performancën në të gjithë rajonin EQL dhe tani mund të përfitojmë nga rritja e tregut për shkak të ruajtjes së pranisë sonë në treg," thotë A. Favey, duke komentuar situatën a tanishme të biznesit në tregjet lindore.

Në të gjithë rajonin EQL, PHS shiti 160,730 makina të reja (+15.1%) në përmjet biznesit të importit dhe gjeneroi një xhiro prej 3.2 miliard € (+18.3%) në vitin 2015.

Ritëm i fortë në pakicë

Me 58 shitës të autorizuar (+2), Porsche Inter Auto (PIA) është zinxhiri drejtues i automjeteve për shitjet me pakicë në Austri. Arriti të shiste 44,188 makina të reja, duke gjeneruar një xhiro prej 1.5 miliard €, njësoj me vitin 2014. Për 2015 janë 3,992 persona (-2.5%) janë të punësuar aktualisht në shitësit e autorizuar me pakicë të Porsche Inter Auto.

Shitjet me pakicë të Porsche Inter Auto në EQL dhe Itali

Porsche Inter Auto përfaqësohet në rajonin EQL dhe Itali nga 56 shitësit e vet të autorizuar Porsche Inter Auto, të cilat po ashtu paraqesin një performancë shumë të suksesshme.

Shitjet e makinave të reja u rritën në 62,264 (+16.9%) automjete, duke gjeneruar një xhiro prej 1.6 miliardë Euro (+20.7%). 3,433 persona (+5.3%) janë të punësuar aktualisht në pikat e autorizuar të PIA jashtë Austrisë.

Shitjet me pakicë të Grupit në Gjermani dhe Spanjë

Prej vitit 2012, PHS ka pasur një total prej 158 pika shitjeje të autorizuar (-5) në Gjermani dhe Spanjë, të cilat kombinojnë në dy

nëndegë, VGRD (Volkswagen Group Retail Deutschland) dhe VGRS (Volkswagen Group Retail Spain).

Me mbështetjen e prirejeve pozitive në tregun e përgjithshëm, në të dyja tregjet u regjistruan rritje.

Me 102 shitës të autorizuar, VGRD dorëzoi 84,827 makina të reja (+6.1%), duke gjeneruar një xhiro prej 3.7 miliardë Euro (+10.7%). Numri i punonjësve u rrit me 2.3% dhe arriti 8,410 persona.

Me një ekip prej 1,565 (+3.6%) persona, VGRS shiti 31,266 makina të reja (+20.1%) dhe gjeneroi një xhiro prej 818 milionë Euro (+17.5%) vitin e fundit.


Banka Porsche vazhdon rrugën e saj të suksessit në një vit jubilar

Me mbi 900,000 kontrata financiare dhe sigurimi në 15 vende në portofolin e vet, Porsche Bank vazhdon rrugën e vet të suksessit. Në Austri, arriti rritje të fortë në financa dhe sigurime sipër shërbime bankare për individë dhe për klientë korporata në vitin 2015. Me rritjen e pjesës së tregut në 26.7%, Porsche Bank vazhdon të jetë udhëheqëse e qartë pas 50 vitesh.

Grupi Porsche Bank punëson në total 1,184 persona (362 të vendosur në Austri).

Porsche Holding Salzburg është kompania më e madhe dhe më e suksesshme e Europës në industrinë e automjeteve. Kompania me bazë në Salzburg u themelua në vitin 1949 dhe tani është aktive në 22 vende në Europën Perëndimore dhe Juglindore, si dhe në Kinë, Kolumbi dhe Kili.

Nga 1 mars 2011, PHS zotërohet me pronësi të plotë nga Volkswagen AG.



Punonjës / Employees

33,124



Makina të reja të regjistruara
New car registration

670,602

> Salzburg, 16 March 2016 - Porsche Holding Salzburg (PHS) turned in another very successful performance in 2015, setting new records in turnover and vehicles sold.

Consolidated turnover increased by 10.2% compared with 2014 to €18.8 bn.

A total of 927,393 new and used cars were sold in wholesale and retail operations, up 6.9% compared with the previous year. New vehicle sales accounted for 670,602 units (+7.6%), UC sales for 256,791 units (+5.2%).

In mid-2015, PHS assumed market responsibility for Bosnia-Herzegovina, meaning that it is now present throughout the entire CEE region as importer and retailer of Volkswagen Group brands.

The company currently has wholesale and retail operations in 25 countries and employs 33,124 people worldwide (+2.5%).

CEE region remains on an upward trajectory

With the exception of Ukraine, the overall market in the CEE countries grew at a strong pace in some cases, although it failed to reach the market high of 2008.

On the 14 markets where PHS is represented in this region, it outpaced regional market growth. With a market share of 18.9% (+0.2%), it improved its market performance significantly.

The sharpest increases were recorded in the Czech Republic, in Hungary and Romania as well as in Albania and Macedonia.

Porsche Česká republika, the largest PHS importer by volume after Austria, increased new car sales to 49,156 vehicles (+37.2%).

"We are very satisfied with the performance

throughout the CEE region and can now benefit from the market growth thanks to having maintained our market presence", says A. Favey, commenting on the current business situation in the Eastern markets.

Across the whole CEE region, PHS sold 160,730 new cars (+15.1%) through its import business and generated turnover of €3.2 bn (+18.3%) in 2015.

Strong momentum in retail

With 58 retail dealerships (+2), Porsche Inter Auto (PIA) is the leading automotive retail chain in Austria. It sold 44,188 new cars, thereby generating turnover of €1.5 bn, which is on a par with 2014. 3,992 people (-2.5%) are currently employed in Porsche Inter Auto's retail dealerships.

Porsche Inter Auto's retail in CEE and Italy

Porsche Inter Auto is represented in the CEE region and Italy by 56 of its own Porsche Inter Auto retail dealerships, which also post a very successful performance.

New car sales climbed to 62,264 (+16.9%) vehicles, generating turnover of €1.6 bn (+20.7%). 3,433 people (+5.3%) are currently employed in PIA's retail dealerships outside Austria.

Group retail in Germany and Spain

Since 2012 PHS has been responsible for a total of 158 own dealerships (-5) in Germany and Spain, which are combined in two subsidiaries, VGRD (Volkswagen Group Retail Deutschland) and VGRS (Volkswagen Group Retail Spain).

Supported by the positive trend on the overall market, increases were achieved on both markets.

With 102 dealerships, VGRD delivered 84,827 new cars (+6.1%), thereby generating turnover of €3.7 bn (+10.7%). The number of employees increased by 2.3% to 8,410.

With a workforce of 1,565 (+3.6%), VGRS sold 31,266 new cars (+20.1%) and generated turnover of €818 m (+17.5%) last year.

Porsche Bank continues track record of success in anniversary year

With over 900,000 finance and insurance contracts in 15 countries in its portfolio, Porsche Bank is continuing its track record of success. In Austria it achieved strong growth in finance and insurance for both retail banking and corporate customers in 2015. Having increased its market share in Austria to 26.7%, Porsche Bank is still the clear leader after 50 years.

Porsche Bank Group employs 1,184 people in total (362 are based in Austria).

Porsche Holding Salzburg is Europe's largest and most successful automotive retail company. The Salzburg-based company was founded in 1949 and now operates in 22 countries in Western and South-East Europe, as well as in China, Colombia and Chile.

Since 1 March 2011 PHS has been a wholly-owned subsidiary of Volkswagen AG.

Audi i ri Q2



Edhe disa muaj na ndajnë nga debutimi i modelit më të ri në kategorinë SUV. Audi Q2 shfaqet në skenë si një karakter i veçantë aspak konformist, një tip urban me prerje të shumta gjeometrike. I projektuar si një automjet rinor dhe ofensiv, Audi Q2 garanton lëvizshmëri gati të pakufizuar në trafikun problematik të qyteteve po aq sa zgjon shpirtin e aventurës jashtë rrugëve të asfaltuara. Q2 nuk druhet të tregojë muskujt. Me shpatulla të gjera dhe tipare të prera, ky model reflekton energji dhe vetëbesim. Tavani që zbret drejt fundit dhe linja e ngritur e dritareve të sjellin ndër mend linjën e një kupeje sportive. Këtë efekt e theksojnë më shumë spoileri i çatisë dhe difuzori agresiv.

Audi Q2 ndryshon dukshëm nga vëllezërit e tij me të mëdhenj. Sepse nuk ka një dizajn të qetë e të lëmuar. Audi Q2 është një tip me cepa, jo si te tjerët. Sepse nuk i druhet vëmendjes.

Audi Q2 ndjehet si në shtëpinë e tij në përditshmërinë urbane po aq sa në aventura fundjave. Dizajni progresiv bashkëjeton me

funksionalitetin e lartë, spontaniteti me sistemet më të avancuara të asistencës dhe multimedias.

Megjithëse kompakt në përmasa (4,19 metra i gjatë, 1,79 metra i gjerë dhe 1,51 metra i lartë) Audi Q2 ofron hapësirën e nevojshme për pesë persona. Volumi i bagazhit varion nga 405 litra deri në 1050 litra me sediljet e pasme të palosura.

Gama e motorëve fillon me 1.0 TFSI, motor 3-cilindërsh benzine me 116 kuaj fuqi dhe 1.6 TDI, motor 4-cilindërsh naftë me 116 kuaj fuqi. Te dy këta motorë kanë një konsum që varion midis 4 dhe 5 litra për 100 km. Motorët me fuqi maksimale, si në versionin e naftës, ashtu dhe në atë të benzinës, kanë cilindrata 2.0 dhe gjenerojnë nga 190 kuaj fuqi. Në të dy rastet janë të pajisur me quattro.

Ndonëse Audi Q2 është SUV-ë më i vogël në portofolin e modeleve të Audi-t, është i pajisur me të gjitha sistemet e asistencës, të cilat përgjithësisht i gjejmë vetëm në modelet e kategorive të larta.

Audi "pre sense front" shmang përmes njohjes së radarit të gjitha situatat e rrezikshme të shkaktuara nga kalimtare të pavëmendshëm apo automjete të tjera në rrugë. Adaptive cruise control me funksionin Stop & Go dhe asistenti i trafikut shfrytëzojnë sensorët me ultratinguj dhe kamerën e përparme duke lehtësuar punën e shoferit në situata të ngarkuara, madje mund të marrin përsipër edhe drejtimin e makinës deri në 65 km/h. Sistem drejtimi progresiv për të shtuar karakterin sportiv, profilin i stilit të ecjes Drive Select me pesë kategori auto, comfort, dynamic, efficiency und individual apo amortizim adaptiv janë disa nga opsionet e shumta me të cilat mund të konfigurohet Audi Q2.

Ashtu siç paralajmërojnë elementet individualizues të dizajnit të jashtëm dhe të brendshëm, Audi Q2 ofron një gamë të gjerë opsionesh atraktive, të përdorura kryesisht nga konsumatorët e moshës së re si Audi smartphone interface, App Audi MMI connect apo Bang & Olufsen Sound System.



#untaggageable

> We are just a few months away from the debut of the newest model in the SUV category. The new Audi Q1 appears on stage as a special and non-conformist character, an urban type with numerous geometrical cuts. Designed as a youth and charging car, the Audi Q2 guarantees unlimited mobility in the problematic city traffic just as it awakens a spirit of adventure in off-track roads. The Q2 is not shy to show off its muscles. With broad shoulders and clear-cut features, the model reflects energy and self-confidence. The roof descending toward the end and the elevated window line remind one of a sporty coupe line. The roof spoiler and the aggressive diffuser enhance that effect even more.

Audi Q2 is evidently different from its larger siblings. It does not have a calm and smooth design. The Audi Q2 is a type with edges, not like the others. That's because it doesn't shy away from attention.

The Audi Q2 feels at home both in the urban

daily life and in weekend adventures. The progressive design coexists with its high functionality; the spontaneity coexists with the most advanced assistance and multimedia systems.

Although compact in its dimensions (4,19 meters long 1.79 meters wide and 1.51 meters high), the Audi Q2 provides the necessary space for five persons. The boot volume varies from 405 liters up to 1050 liters with the folded back seats.

The engine range begins with 1.0 TFSI, with a 3-cylinder 116hp gasoline engine and the 1.6 TDI, with a 4-cylinder 116hp diesel engine. Both engines have a consumption that varies between 4 and 5 liters per 100km. Maximal power 2.0 engines, both in the diesel and gasoline versions, generate 190hp and in both cases are equipped with quattro.

Although the Audi Q2 is the smallest in the Audi range, it is equipped with all the assistance systems that you generally find

only in the higher range models.

Audi pre sense front uses radar to avoid all hazardous situations that can occur with careless pedestrians or other vehicles in the street. The Adaptive cruise control with the Stop & Go function and the traffic assist make use of ultrasound sensors and the front camera to make it easier for the driver in certain situations and may also take over driving up to 65 km/h. the progressive steering system to add to the sporty character, the driving style profile Drive select with five categories – auto, comfort, dynamic, efficiency and individual, or adaptive damping are some of the many options to configure the Audi Q2 with.

As the individual elements of the exterior and interior design signal, the Audi Q2 provides a broad spectrum of attractive options, used mainly by young consumers, such as the Audi smartphone interface, App Audi MMI connect or the Bang & Olufsen Sound System.





Prej vitesh tashmë flitet për konkurrencën që motorët elektrikë po i bëjnë atyre me djegie të brendëshme. Madje edhe rënia e çmimit të naftës dhe gazit në tregjet botërore mendohet të jetë ndikuar pikërisht nga ky trend, që tregon rritjen e përgjegjshmërisë së njerëzimit përkundrejt natyrës. Nuk ka asnjë dyshim që çështjet mjedisore kanë marrë një rëndësi madhore në vitet e fundit dhe një nga kollonat kryesore që pritet të ketë ndikim në ngadalësimin e ritmit të ngrohjes globale, është ulja e ndotjes së krijuar nga emetimi i gazrave të automjeteve. Disa shtete evropiane kanë avancuar jashtëzakonisht shumë në këtë fushë, duke krijuar legjislacinon e nevojshëm që pas vitit 2020 (Norvegjia) dhe pas vitit 2025 (Hollanda) të mos tregohen më automjete me motorr me djegie të brendëshme. Këto hapa nënkuptojnë

pa ekzagjerim një revolucion që pritet të ndodhë shumë shpejt në tregun e automjeteve. Në funksion të këtij qëllimi Volkswagen po kryen një rol aktiv, duke ofruar disa modele hibride (benzine + elektrike: Jetta, Golf GTE, Passat GTE) si dhe dy automjete krejtësisht elektrike: e-up! dhe e-Golf. Me një pavarësi prej rreth 160 km për e-up! dhe 190 km për e-Golf, këto dy automjete përshtaten mjaft mirë për lëvizjet e përditshme. Ato janë të pajisura me kabull dhe adaptor në mënyrë që të mundësojnë karikimin nga çdo prizë e zakonshme. Me anë të kësaj metode të thjeshtë, arritja në 100% të kapacitetit të baterisë zgjat jo më shumë se 8 orë. Megjithatë, për ata që e kanë më me ngut, teknologjia e zhvilluar nga Volkswagen dhe partnerët mundëson edhe karikimin e shpejtë prej vetëm 30 minutash të 80% të kapacitetit

të baterisë. Me një konsum prej vetëm 12.7 kWh për 100 km (afërsisht 150 ALL), ulja e kostove që mundësojnë këto mjete është mesatarisht 7-fish me motorët e naftës dhe 10-fish me ato të benzinës. Gjithashtu nëse llogarisim që automjetet elektrike nuk kanë nevojë për shërbime periodike (vaj+filtra) kursimi është edhe më i madh.

Duke patur vizionin që edhe në Shqipëri ashtu si në vendet e Bashkimit Evropian, automjetet elektrike do të shihen me perspektivë dhe me besimin tek marka Volkswagen. Objektivi ynë është që Porsche Albania të jetë koncesionari i parë në rajon që do të ofrojë mundësi shitjeje dhe servisi për mjete të kësaj teknologjie.

Nuk do të jetë e largët dita që do i shohim (jo dëgjojmë) në rrugët e Tiranës!



For years now, there is talk about the competition that electric engines are waging toward internal combustion ones. In fact, even the drop in the price of oil and gas in global markets is thought to have been influenced precisely by this trend, which demonstrates an increased responsibility of mankind towards nature. There is no doubt that environmental issues have assumed major significance in recent years and one of the main pillars that is expected to influence the slowdown of the pace of global warming is the reduction of pollution created by emissions of vehicle gas. Some European countries have advanced incredibly in this area, creating the necessary legislation so that after 2020 (Norway) and after 2025 (Netherlands) will no longer register vehicles with internal combustion engines. Such steps

indicate without exaggeration a revolution expected to take place very soon in the automobile market.

To that end, Volkswagen has undertaken an active role by providing some hybrid models (gasoline + electrical: Jetta, Golf GTE, Passat GTE) as well as two entirely electric vehicles: e-up! and e-Golf. With an independence for about 160 km for e-up! and 190 for e-Golf, these two vehicles are perfectly fitting for daily movements. They are equipped with cable and adaptor that would enable charging on any ordinary socket. Through this simple method, charging 100% of the battery capacity takes no more than 8 hours. However, for those in a hurry, the technology developed by Volkswagen and partners enables fast charging for only 30 minutes up to 90% of the battery capacity. With a

consumption of only 12.7 kWh per 100 km (approximately 150 ALL), the cost reduction that these vehicles enable is about 7 times less than that of diesel engines and 10 times less than that of gasoline engines. Moreover, if we factor in the fact that electric vehicles need no periodical services (oil+filters), saving is even greater.

Having the vision that in Albania, just as in European Union countries, electric vehicles will be seen as having a perspective and with the confidence in the Volkswagen brand, our objective is for Porsche Albania to be the first importer in the region that will have sales and after sales capacities for this new technology.

The day won't be far when we see (not hear) them in the streets of Tirana!

Armand Saliu
Drejtor Volkswagen Makina Pasagjerësh
Volkswagen Passenger Vehicles Brand Manager

Volkswagen E-Golf



E-Servis



> Hedhja në treg e makinave elektrike qofshin ato hibride (e kombinuar me motor me djegje të brendëshme) ose totalisht elektrike ka dhënë një impakt shumë pozitiv edhe në kostot e mirëmbajtjes të vetë kësaj tipologjie mjeti, sidomos kur flasim për kategorinë BEV (Battery Electric Vehicle).

Tashmë është anashkaluar pargjykimi se kjo lloj teknologjie tërheq vetëm ambientalistët apo përdoruesit e etur të teknologjive të reja (early adopters). Mjafton një vlerësim i asaj çka në industrinë tonë i referohemi si TOC (Total Cost of Ownership) për të kuptuar se përfimi në kosto do të bindte edhe më

skeptikët për avantazhet që kjo teknologji ofron. Kontrolli periodik i makinave elektrike 'lehtësohet' një pjesë të rëndësishme të shërbimeve të dosmosdoshme në makinat me motor me djegje të brendëshme. Makinat elektrike në kontrollet periodike dhe shërbimet e tyre limitohen vetëm në ndërrimin e filtrit të kondicionerit që do të thotë jo më vaj motorit dhe filtër vaji jo më filter karburanti dhe jo më filtër ajri për motorin.

Ndërrimi i ferrotave bëhet për një kohë tre herë më të gjatë sesa makinat normale sepse frenimi i moderuar kryhet nëpërmjet motorrit elektrik.

Blloku i baterive për mjetet BEV, që është edhe komponenti më i kushtueshëm i këtyre makinave, vjen me 8 vjet garanci nga grupi Volkswagen.

Prurja e teknologjive të reja paralelisht me vendet më të zhvilluara Europiane është pjesë thelbësore e strategjisë së Porsche Albanias. Për këtë arsye po punohet intensivisht për të zhvilluar kapacitetet edhe në servis për të trajtuar këto mjete. Trajnimet e vazhdueshme të stafit, pajisjet e reja që do të bëjnë karikimin e shpejtë apo diagnostifikimin janë vetëm disa aspekte nga puna e përditshme për të ofruar një shërbim cilësor për drejtuesit e këtyre mjeteve.

> The launch in the market of electric cars whether hybrid ones (combined with internal combustion engines) or totally electric ones has had a very positive impact also on the maintenance costs of this type of vehicle, especially when it comes to the BEV (Battery Electric Vehicle) category.

The prejudice that this kind of technology is only attractive for environmentalists or eager early adopters of new technologies has been already overcome. An evaluation of what in our industry is referred to as TOC (Total Cost of Ownership) would suffice to understand that the cost benefit would convince even the most skeptical about the advantages that this technology offers.

The periodical checkup of electric cars 'facilitates' an important part of essential services for internal combustion engine vehicles. In their periodical checkups and services, electric cars are confined to

changing the air conditioning filter, which means no more engine oil and oil filter, no more fuel filter, and no more engine air filter.

The changing of breaking pads is done during periods that are three times longer than for normal cars because moderate braking is conducted through the electrical engine. BEV's battery block, which is the most expensive component of these vehicles, comes with an 8-year warranty from the Volkswagen group.

Bringing the newest technologies at the same time as in the most developed European countries is an essential part of Porsche Albania's strategy. That is why we are working intensively to develop capacities in the service sector to handle these vehicles. Continued training for staff, new equipment that will carry out fast charging or diagnostics are only some of the aspects of daily work that aims at providing quality services for the drivers of these vehicles.



Engert Gjikhima
Drejtues i departamentit të riparimeve të përgjithshme. Porsche Albania
Head of General Repairs Department

Në udhëtim

On The Road



Kemi folur shpesh për modelin më popullor të Volkswagen Makina Tregtare, Volkswagen Caddy. E megjithëse kemi mbuluar në çdo kënd makinën dhe tipareve të saj, pak ose aspak kemi përshkruar atë çka makina mund të bëjnë provën më të vështirë: Një ditë pune.

Për të bërë një gjë të tillë kemi ndjekur një nga klientët tanë i cili pranoi të shoqërohej nga ekipi i revistës Drive përgjatë një dite pune.

Eduart Beqiri ka arritur të ngrejë një sipërmarrje të suksesshme në një treg në zhvillim siç është ai i materialeve elektrike. Prej vitesh ai është pronar i një Volkswagen Caddy, makinë të cilën pas shumë vitesh pune në rrugë vendosi ta ndërrojë tërësisht me një Volkswagen Caddy edhe më të fuqishme.

Drive: Kur fillon dita juaj e punës?

E. B. Zakonisht në orën 7:00 duhet të sigurohem që pikat e shitjes dhe magazina të kenë furnizimet për aktivitetin e pritsëm të ditës. Përgjithësisht furnizimi ndodh një ditë përpara, megjithatë kontrolli në fillim të ditës është i domosdoshëm.

Drive: për

Prej vitesh tashmë ju dorni për nevojat e biznesit Volkswagen

Caddy. Si është rituali i mëngjesit për makinën?

E. B. Caddy është shoqëruesi i ditës së punës dhe jashtë saj. Një tipar i imi dallues është se e kam të vështirë të pranoj dikë tjetër në timon dhe prandaj çdo lëvizje me makinë për punë ose personale e bëj vetë dhe vetëm me Caddy.

Në sajë të hapësirës së bollshme, marrja apo dërgimi i furnizimeve nga furnitorët apo klientët bëhet shpejt dhe pa pengesa. Në bizneset e vogla dhe të mesme shpesh herë shpejtësia me të cilën mund të reagosh ndaj kërkesës përcakton suksesin e ditës apo ecurinë e një produkti. Projektet e ndërtimit apo klientët kërkojnë që produkti të jetë aty në kohën e premtuar dhe për të arritur këtë ka nevojë për planifikim, por edhe bashkëpunëtor të sigurt (e them me bindje të plotë se Caddy është një prej tyre).

Drive: Sa kohë në ditë shpenzoni në makinë?

E. B. Asnjë ditë nuk është e njëjtë. Ka ditë kur në sajë të kërkesës apo problemeve që kërkojnë zgjidhje të jem 5-6 orë në ditë në timon, sikundër ka ditë që lëviz më pak.

Drive: Pas afërsisht pesë vitesh nën drejtimin

e Volkswagen Caddy ju rizgjidhni këtë model por me disa ndryshime. Si e shpjegoni këtë vendim?

Një shprehje thotë që 'ekipi fitues nuk ndërrohet'. Pas afërsisht pesë vitesh nën timonin e Caddy-t e them me bindje se nuk kam pasur surpriza. E di që makina do më përgjigjet në çdo kohë, çdo stinë e çdo terren ku do të më çojë puna.

Por, me rritjen e punës rritet edhe kërkesa. Mua më duhej një makinë edhe më e fuqishme për nevojat e ditës së punës, por edhe jashtë saj. Për këtë arsye kalova nga Caddy 1.6 TDI tek version më i fuqishëm 2.0 TDI DSG 120 kf.

Drive: Nëse do t'ju kërkoja të shihni në 3 vitet e ardhshme, çfarë shihni për biznesin tuaj?

E. B. Shqipëria është vend i vështirë për parashikim, qofshin këto edhe afatmesëm, por nëse do të vazhdoj t'ju vijë në ndihmë klientëve të mi për të qenë të suksesshëm, është e sigurt se ky sukses do të vazhdojë edhe për sipërmarrjen time. Për të qenë aty për klientët e mi, kam nevojë për partnerë të besueshëm dhe Caddy im është një prej tyre.

Drive: Faleminderit për kohën dhe mundësinë dhe suksese të mëtejshme.

E. B. Faleminderit ju.





We have talked often about the most popular model of Volkswagen Commercial Vehicles, Volkswagen Caddy. Yet, although we have

covered every angle of the car and its features, we have devoted little or no attention to what the car is capable of in the most difficult test of all: a workday.

To do that, we accompanied one of our customers who agreed to be shadowed by the Drive magazine team during a day of work.

Eduard Beqiri has managed to build a successful enterprise in a developing market as the one of electrical materials is. For years, he owns a Volkswagen Caddy; after many years of work on the road, he decided to replace it again with an even more powerful Volkswagen Caddy.

Drive: When does your workday begin?

